

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË

Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete

**Zbatimi i Strategjisë për riintegrimin e personave të
riatdhesuar në komunat e Kosovës**

Nëntor 2009

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
1. HYRJE.....	2
2. KORNIZA E POLITIKAVE	3
3. ZBATIMI I STRATEGJISË PËR RIINTEGRIM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR NË NIVEL KOMUNAL	4
3.1 Mekanizmat bashkëndues	4
3.2 Riintegrimi në komunat e origjinës	7
3.2.1 Dokumentet civile.....	7
3.2.2 Shëndetësia.....	8
3.2.3 Arsimi.....	9
3.2.4 Punësimi dhe mirëqenia sociale	10
3.2.5 Banimi dhe vendosja.....	11
4. PËRFUNDIMET.....	12
5. REKOMANDIMET	13

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Sipas Strategjisë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (Strategjia)¹, riatdhesimi ose kthimi me forcë përfshinë personat me origjinë nga Kosova, të cilëve u është mohuar statusi i refugjatit apo ndonjë status tjetër ligjor në vendet nikoqire dhe të cilët janë riatdhesuar në Kosovë me urdhër zyrtar ose aktvendim të gjykatës. Në janar 2008, Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) i barti disa kompetenca të kufizuara të ripranimit të autoritetet e Kosovës. Pas kësaj, institucionet e Kosovës gradualisht morën përgjegjësinë mbi aktivitetet tjera të riatdhesimit dhe ripranimit. Ky raport e vlerëson angazhimin e autoriteteve të Kosovës për t'i përmbushur obligimet e tyre sipas Strategjisë dhe për të krijuar kushte për pranimin dhe riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në shoqërinë e Kosovës. Gjetjet e prezantuara janë të bazuara në aktivitetet e rregullta monitoruese të Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë, në fushën e të drejtave të njeriut, pjesëmarrjes së komuniteteve në proceset vendimmarrëse dhe mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre.

Raporti gjen që autoritetet lokale të Kosovës nuk i kanë përmbushur sa duhet obligimet e tyre për ta përkrahur riintegrimin e personave të riatdhesuar në Kosovë nga shtetet nikoqire. Prej miratimit të Strategjisë në tetor të vitit 2007, janë ndërmarrë vetëm disa hapa për t'i zbatuar objektivat e saj në nivel lokal, si dhe nuk janë ndarë fondet e nevojshme për ta zgjatur asistencën e veçantë të riintegrimin për personat e riatdhesuar, ashtu siç është paraparë me Planin e Veprimit për zbatimin e saj². Strategjia nuk është shpërndarë gjerësisht në nivel lokal dhe në përgjithësi ekziston një mungesë e njohurisë në mesin e autoriteteve përkatëse lokale për rolet dhe përgjegjësitë e tyre përkitazi me personat e riatdhesuar. Masat konkrete për ta lehtësuar riintegrimin e personave të riatdhesuar në fushat kyçe si shëndetësia, arsimi, punësimi dhe banimi ende mungojnë, kurse në buxhetet përkatëse komunale nuk janë përfshirë kurrfarë shpenzimesh në lidhje me riintegrimin e personave të riatdhesuar. Në fund, themelimi dhe funksionimi i duhur i mekanizmave të referimit dhe bashkërendimit mes nivelit qendror dhe atij lokal, ashtu siç është përvijuar në këto dokumente, mbetet sfidë e madhe për të gjithë hisedarët e përfshirë.

Si pasojë e kësaj, kur personat e riatdhesuar arrijnë në Kosovë, ata mbesin shpesh herë pa kurrfarë ndihme, informate për qasje në shërbime, apo mundësi tjetër të riintegrimin. Mungesa e asistencës me të cilën përballen personat e riatdhesuar³ në lidhje me banim, shkollim dhe mundësi ekonomike shpesh herë nënkupton probleme serioze të riintegrimin për individë dhe familje, ne veçanti për personat e komuniteteve joshumicë⁴.

¹ Strategjia e UNMIK-ut/IPVQ-ve për riintegrimin e personave të riatdhesuar (Strategjia), e aprovuar nga ana e qeverisë së Kosovës më 10 tetor 2007.

² Plani i veprimit i qeverisë së Kosovës për Strategjinë për riintegrimin e personave të riatdhesuar (Plani i veprimit), prill 2008.

³ Qeveria e Kosovës nuk ka programe ekzistuese të rindërtimit të shtëpive për të kthyerit me forcë. Kjo kategori e të kthyerve duhet të dallohet nga të kthyerit e vullnetshëm, për të cilët qeveria e Kosovës ka disa programe të asistencës për kthime të vullnetshme, duke përfshirë edhe disa programe të rindërtimit të shtëpive.

⁴ Për qëllim të këtij raporti, komunitete joshumicë janë të gjitha ato komunitete që përbëjnë një pakicë numerike në nivel komunal në Kosovë.

Ky raport përfshinë një numër rekomandimesh për pushtetin qendror dhe autoritetet lokale përkatëse, si dhe për akterët ndërkombëtarë dhe vendet nikoqire. Ato theksojnë rëndësinë për një bashkëpunim dhe ndarje më të madhe të informacioneve mes hisedarëve të përfshirë, për themelimin dhe forcimin e mekanizmave dhe kapaciteteve për t'i adresuar nevojat e personave të riatdhesuar, dhe për ndarjen e burimeve të nevojshme nga buxheti për zbatimin e Strategjisë. Me përkrahjen e vendeve nikoqire, institucionet e Kosovës duhet t'i ndërmarrin të gjitha masat e domosdoshme për t'i krijuar kushtet për pranimin dhe riintegrimin e personave të riatdhesuar, në mënyrë që të mundësohet kthimi i tyre i sigurt dhe me dinjitet dhe riintegrimi i qendrueshëm në shoqërinë kosovare.

1. HYRJE

Viteve të fundit, shtetet në të cilat ishin vendosur një numër i madh i personave të zhvendosur nga Kosova gjithnjë e më shumë kanë kërkuar që t'i kthejnë ata në vendin e tyre të origjinës. Sipas statistikave të Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), mes janarit dhe shtatorit të vitit 2009, në Kosovë janë riatdhesuar me forcë gjithsej 2,144 persona, 130 prej të cilëve u takojnë komuniteteve që konsiderohen të rrezikuara dhe kanë nevojë për mbrojtje të vazhdueshme ndërkombëtare nga ana e UNHCR-së.⁵ Gjatë vitit 2008, me forcë u kthyen 2,550 persona, në krahasim me 3,219 në vitin 2007, 3,569 në vitin 2006 dhe 3,554 në vitin 2005.⁶ Shumica e personave të riatdhesuar janë shqiptarë, mirëpo kthimet me forcë gjithnjë e më shumë po i përfshijnë edhe personat që u takojnë komuniteteve joshumicë, përkatësisht komunitetit rom, ashkali, egjiptian dhe serb, si dhe atij shqiptar në pjesët veriore të Kosovës.⁷ Serbët, romët dhe shqiptarët në situata kur përbëjnë pakicën në nivel komunal vazhdojnë të konsiderohen nga UNHCR-ja të jenë në rrezik.⁸

Në një përpjekje për t'i krijuar politikat gjithëpërfshirëse të riatdhesimit dhe kornizën operative, si dhe për t'u përgatitur për bartjen e kompetencave, Zyra e UNMIK-ut për komunitete, kthim dhe çështje të pakicave dhe Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) në vitin 2007 i zhvilluan Politikat e ripranimit⁹, si dhe Strategjinë¹⁰. Më 1 nëntor 2008, qeveria e Kosovës filloi komunikimin e drejtpërdrejtë me vendet nikoqire mbi kërkesat për ripranim dhe çështjet tjera lidhur me

⁵ Pasqyrë statistikore e UNHCR-së – ashtu si ishte në fund të shtatorit të vitit 2009. Sipas Dokumentit të fundit të qëndrimit të UNHCR-së për nevojat për mbrojtje ndërkombëtare të individëve nga Kosova (2006), serbët, romët dhe shqiptarët në vendet ku janë pakicë në nivel komunal vazhdojnë të jenë të rrezikuar nga përndjekja dhe do të duhej të vazhdojnë të përfitojnë nga mbrojtja ndërkombëtare në shtetet e azilit.

⁶ Pasqyrë statistikore e UNHCR-së – ashtu si ishte në fund të shtatorit të vitit 2009.

⁷ Sipas Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, riatdhesimi ose kthimi me forcë i përfshin ata persona që nuk e kanë fituar statusin e refugjatit apo ndonjë status tjetër dhe janë riatdhesuar në Kosovë nga shtetet e treta në bazë të urdhrave zyrtarë apo vendimeve të gjykatave. (Kapitulli 1).

⁸ Shih Raportin e UNHCR-së të Gjendjes mbi nevojat e individëve nga Kosova për mbrojtje të vazhdueshme ndërkombëtare (qershor 2006).

⁹ Politikat e ripranimit UNMIK/IPVQ, tetor/nëntor 2007.

¹⁰ Shih fusnotën 1.

riatdhesimin dhe filloi negociatat dypalëshe për marrëveshjet e ripranimit me disa shtete të Evropës perëndimore.¹¹

Duke pasur parasysh këtë bartje të kompetencave, ky raport e përshkruan dhe vlerëson angazhimin e autoriteteve lokale të Kosovës për t'i përmbushur obligimet e tyre sipas kornizës së politikave ekzistuese për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe për të përgatitur planet e synuara për t'i ndihmuar të kthyerve që të riintegrohen në shoqërinë e Kosovës. Raporti nuk i përshkruan procedurat ligjore apo të azilit të vendeve nikoqire që kanë rezultuar me refuzim të statusit dhe riatdhesim, por përqendrohet në politikat dhe procedurat ekzistuese për t'i krijuar kushtet për pranimin dhe riintegrimin e qëndrueshëm të personave në komunat e tyre të origjinës.

2. KORNIZA E POLITIKAVE

Deri rishtas, UNMIK-u ishte institucioni kryesor për menaxhimin e ripranimit dhe riatdhesimit të personave me origjinë nga Kosova.¹² Prej vitit 1999, UNMIK-u ka bashkëpunuar me më shumë se 20 shtete¹³ për të siguruar që riatdhesimet të kryhen në mënyrë graduale dhe me dinjitet, dhe për ta parandaluar riatdhesimin me forcë të personave që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, në veçanti të personave që i takojnë komuniteteve joshumicë dhe grupeve tjera të cenueshme.¹⁴ Çështjet e sigurisë, mungesa e strehimit/banimit, shërbimet joadekuate shëndetësore, rrjeti i pazhvilluar i sigurisë sociale dhe kapacitetet dhe resurset e kufizuara komunale për ta ndihmuar riintegrimin e tyre e shtyri UNMIK-un që ta kufizojë numrin e të riatdhesuarve në Kosovë.¹⁵ Në të njëjtën kohë, UNMIK-u iu kërkoi shteteve nikoqire që të përgatisin plane të riintegrimit dhe pako të ndihmës, duke përfshirë përkrahjen financiare, aftësimet, punësimin dhe programe të gjenerimit të të ardhurave, banimin dhe ndihma tjera për riintegrim në mënyrë që të përkrahet kthimi i vullnetshëm i këtyre personave dhe të mundësohet riintegrimi i qëndrueshëm i tyre në Kosovë.

Në proces të bartjes së kompetencave të institucionet e Kosovës, Zyra e UNMIK-ut për komunitete, kthim dhe çështje të pakicave i përkrahu IPVQ-të për ta zhvilluar një strategji për ta menaxhuar dhe lehtësuar riintegrimin e personave të riatdhesuar në shoqërinë e Kosovës. Më 25 tetor 2006, qeveria e Kosovës e formoi një Këshill drejtues të përbërë nga përfaqësuesit e ministrive gjegjëse dhe organizatave

¹¹ Në një letër drejtuar ambasadave dhe zyrave ndërlidhëse në Kosovë, të datës 15 tetor 2008, Ministria e punëve të brendshme, përkatësisht Departamenti për kufi, azil e refugjatë i informoi vendet nikoqire që prej 1 nëntorit 2008, në vend të Zyrës së UNMIK-ut për komunitete, kthim dhe çështje të pakicave, ministria do t'i ketë të gjitha përgjegjësitë për ripranim dhe riatdhesim dhe do të veprojë si pika kryesore kontaktuese për të gjithë homologët.

¹² Si pjesë e pushtetit të tij të rezervuar për punë të jashtme dhe kontroll të kufirit, siç është përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 mbi Kornizën kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë, të datës 15 maj 2001.

¹³ Marrëveshje/Memorandume specifike ishin nënshkruar me Gjermaninë, Zvicrën dhe Suedinë.

¹⁴ Prej vitit 1999, politikat e riatdhesimit të UNMIK-ut kanë qenë të bazuara në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe rekomandimet e UNHCR-së. Në pajtim me këtë, UNMIK-u nuk e ka pranuar riatdhesimin e personave që vazhdojnë të kenë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare sipas UNHCR-së. Në të njëjtën kohë, UNMIK-u nuk ishte kundër riatdhesimit të vullnetshëm të personave me origjinë nga Kosova. (Sqarim shtesë i UNMIK-ut mbi politikat e riatdhesimit, qershor 2006).

¹⁵ Sqarim shtesë i UNMIK-ut mbi politikat e riatdhesimit, qershor 2006, si dhe viteve tjera.

ndërkombëtare dhe ekspertët ndërkombëtarë dhe vendorë.¹⁶ Këshilli drejtues u ngarkua me detyrën për ta arritur marrëveshjen për rolet dhe përgjegjësitë e ministrive përkatëse dhe autoriteteve lokale në fushën e riintegritimit të personave të riatdhesuar, si dhe për t'i zhvilluar procedurat dhe mekanizmat për ta menaxhuar procesin e riintegritimit. Më 10 tetor 2007, qeveria e Kosovës e aprovoi Strategjinë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar.

Strategjia përmban synime specifike dhe masa konkrete në fushën e riintegritimit ligjor, shëndetësisë, arsimit, punësimit, mirëqenies sociale dhe çështje në lidhje me pronën dhe banimin për ta siguruar kthimin e qëndrueshëm dhe riintegrimin e personave të riatdhesuar. Vëmendje e veçantë i është kushtuar nevojave të pjesëve të cënueshme të shoqërisë dhe komuniteteve joshumicë. Me Strategji caktohen përgjegjësitë e institucioneve përkatëse qendrore dhe lokale, paraqiten mekanizma referimi dhe bashkërendimi mes nivelit qendror dhe lokal, dhe kërkohet themelimi i këshillit bashkërendues ndërministror për ta mbikëqyrur dhe monitoruar zbatimin e Strategjisë. Strategjia është e bazuar në “analizën kritike dhe vlerësimin e problemeve nga këndvështrime të ndryshme, me vëmendje të veçantë në ndikimet socio-ekonomike në mënyrë që të mbahet nën kontroll situata e kthimeve të pavullnetshme dhe procesi i riintegritimit të personave të riatdhesuar”¹⁷. Ajo do të zbatohet përmes një plani të veprimit dhe programeve të përshtatshme, ku caku kryesor është që personat e riatdhesuar të riintegrohen në të gjitha sferat e jetës publike në bazë të parimit të barazisë.

Në prill të vitit 2008, qeveria e Kosovës e finalizoi planin e veprimit të Strategjisë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar. Ai përfshin projektimet buxhetore për secilën ministri në fushat specifike të identifikuar përmes Strategjisë dhe përcakton hollësisht punën dhe veprimet konkrete të autoriteteve përkatëse qendrore dhe lokale, si dhe afatin kohor për zbatimin e tyre. Llogaritë janë të bazuara në një numër prej afërsisht 5,000 persona të riatdhesuar në vit.

3. ZBATIMI I STRATEGJISË PËR RIINTEGRIM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR NË NIVEL KOMUNAL

3.1 Mekanizmat bashkërendues

Zyra komunale për komunitete dhe Zyrtarët komunal për kthim

Mandati specifik i zyrave komunale për komunitete dhe zyrtarëve komunal për kthim¹⁸ është për të garantuar që politikat dhe shërbimet komunale u përgjigjen

¹⁶ Këshilli drejtues bashkë-kryesohej nga Ministria e punëve të brendshme dhe Zyra e UNMIK-ut për komunitete, kthim dhe çështje të pakicave, dhe përbëhej nga përfaqësuesit e Ministrisë së punës dhe mirëqenies sociale, Ministrisë së ambientit dhe planifikimit hapësinor, Ministrisë së administrimit të pushtetit lokal, Ministrisë së punëve të brendshme, Ministrisë së shëndetësisë, Ministrisë së arsimit, shkencës dhe teknologjisë, organizatave ndërkombëtare (UNMIK, UNHCR, OSBE, Organizata ndërkombëtare për migrim, Ekipi planifikues i Bashkimit Evropian), dhe ekspertë tjerë ndërkombëtarë dhe vendorë, duke përfshirë edhe zyrtarët komunal për komunitete.

¹⁷ Strategjia, Kapitulli 1, Hyrje.

¹⁸ Shih Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2007/30 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës dhe Doracakun e rishikuar për kthim të qëndrueshëm, të vitit 2006.

nevojave të të gjitha komuniteteve, duke përfshirë të kthyerit, që jetojnë brenda territorit të një komune të caktuar. Strategjia, pra, ia cakton këtyre zyrove rolin bashkërendues mes institucioneve qendrore dhe lokale. Saktësisht, zyrat komunale për komunitete dhe zyrtarët komunal për kthim veprojnë si pikë kryesore për komunikim mes nivelit qendror dhe lokal; shërbejnë si pikë e parë e kontaktit për personat e riadhesuar në nivel lokal; ua raportojnë nevojat e personave të riadhesuar zyrove tjera kompetente brenda administratës komunale; dhe u ofrojnë të kthyerve informata për të drejtat e tyre dhe përkrahjen në dispozicion.¹⁹

Fatkeqësisht, zyrtarët përkatës komunalë duket të ketë pak njohuri për ekzistimin dhe përmbajtjen e kornizës së politikave për riintegrimin e personave të riadhesuar. Përveç katër zyrtarëve komunal për kthim²⁰ dhe një zyrtari komunal për komunitete²¹, asnjë nga zyrtarët e konsultuar nuk kishte pranuar kopjen e Strategjisë apo të Planit të veprimt. Rrjedhimisht, vetëm një numër shumë i kufizuar i zyrtarëve komunal është i vetëdijshëm për përmbajtjen dhe masat konkrete të parapara në këto dy dokumente.

Në fakt, shumica e komunave të Kosovës nuk e kanë caktuar një organ komunal për t'u bashkërenduar me institucionet e nivelit qendror për çështjet që kanë të bëjnë me riintegrimin e personave të riadhesuar. Shumë komuna theksuan, si hipotezë, që roli bashkërendues do t'i takonte zyrtarit komunal për kthim.²² Megjithatë, në shumë raste, zyrtarët komunal për kthim nuk janë të vetëdijshëm për rolet dhe përgjegjësitë e tyre specifike përkitazi me riintegrimin e personave të riadhesuar: ata nuk kanë marrë udhëzime të qarta, e as përkrahje financiare apo politike nga udhëheqja komunale për t'i kryer detyrat e tyre.

Duhet të përmendet që asnjë nga komunat e Kosovës nuk ka pranuar deri më tani ndonjë lajmërim paraprak nga niveli qendror në lidhje me kthimet e pavullnetshme në të ardhmen.²³ Zyrtarët e konsultuar komunalë në të gjitha komunat theksuan që nuk kanë pranuar kurrfarë informatash për hollësitë e ardhjes, për numrin e personave të riadhesuar dhe/ose nevojat specifike të tyre. Këto hollësi kërkohen për ta rregulluar pranimin e tyre dhe për t'i përkrahur në mënyrë efikase personat me nevojat më të veçanta.²⁴ Në përgjithësi, zyrtarët komunal për komunitete dhe zyrtarët komunal për kthim pohojnë që kurrë nuk i ka kontaktuar ndonjë institucion i nivelit qendror në

¹⁹ Strategjia, Kapitulli 8, Partneriteti dhe përgjegjësitë në vijat horizontale dhe vertikale, dhe Kapitulli 9, Mekanizmat bashkërendues për zbatimin e Strategjisë për riintegrimin e personave të riadhesuar.

²⁰ Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane, Obiliq/Obilić dhe Podujevë/Podujevo.

²¹ Ferizaj/Uroševac.

²² Han i Elezit/Đeneral Janković, Kamenicë/Kamenica, Kaçanik/Kaçanik, Novo Brdo/Novobërdë, Štrpce/Shtërpçë, Viti/Vitina, Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Leposavić/Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan/Zveçan, Podujevë/Podujevo, dhe Shtime/Štimlje.

²³ Sipas Strategjisë, Ministria e administrimit të pushtetit lokal, pasi që të ketë marrë informatat nga Ministria e punëve të brendshme dhe Ministria e punës dhe mirëqenies sociale, është përgjegjëse për t'i informuar komunat për hollësitë e ardhjes dhe numrin e personave të riadhesuar, si dhe nevojat e tyre të veçanta, duke përfshirë këtu edhe ato të banimit, shëndetësisë dhe arsimit. Kjo, si pjesë e asistencës fillestare të pranimit, është e nevojshme për t'i garantuar hapat e mëtejshëm nga autoritetet përkatëse komunale dhe për ta lehtësuar riintegrimin e tyre në komunën e origjinës. (Kapitulli 1).

²⁴ Vetëm zyrtari komunal për komunitete në Ferizaj/Uroševac theksoi që në të kaluarën kishte pranuar informata në lidhje me kthimet e pritura të pavullnetshme, ku ishin ofruar informatat për hollësitë e ardhjes dhe për numrin e personave të riadhesuar, por jo edhe informatat për nevojat e veçanta të këtyre personave.

lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me raste individuale dhe/ose politika dhe programe ekzistuese të qeverisë në këtë drejtim

Zyrtarët komunalë për komunitete dhe zyrtarët komunalë për kthim në 15 prej 33 komunave të Kosovës mbledhin të dhëna për personat e riatdhesuar, edhe pse të dhënat mbledhen vetëm për ata persona që u drejtohen drejtpërdrejt zyrave të tyre për ndihmë.²⁵ Asnjë institucion tjetër nuk mban shënime të tilla. Bazat e të dhënave të personave të riatdhesuar mbahen në nëntë komuna.²⁶ Mirëpo, sasia dhe cilësia e informatave që gjendet në këto baza të të dhënave është e diskutueshme. Informatat e regjistruara shpesh herë kufizohen vetëm në të dhënat elementare të të kthyerve dhe, në disa raste, vendbanimin e tyre. Dy komuna tjera raportojnë që nuk kanë pasur raste të personave të riatdhesuar gjatë periudhës për të cilën raportohet dhe si të tilla nuk mbajnë shënime për personat e riatdhesuar.²⁷ Në fund, 16 komuna të Kosovës nuk mbajnë kurrfarë shënimesh për personat e riatdhesuar.²⁸

Drejtorët komunalë dhe kuvendet komunale

Në nivel lokal, drejtorët komunal për shëndetësi apo arsim dhe drejtoritë tjera e kanë përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin e Strategjisë në bashkërenditje me Ministrinë e administrimit të pushtetit lokal dhe këshillin bashkërendues ndërmnistror (që pritet të themelohet). Drejtorët komunalë, veçanërisht, u japin rekomandime për politika komiteteve përkatëse të kuvendit të komunës; bashkërendojnë punën e zyrtarëve komunal për kthim dhe zyrtarëve komunal për komunitete në lidhje me rastet individuale; përgatisin raporte të progresit për zbatimin e Strategjisë; dhe e propozojnë buxhetin për secilën fushë të riintegritit të caktuar përmes Strategjisë. Komiteti i kuvendit të komunës për politika dhe financa garanton që politikat të kthehen në veprime nga ana e autoriteteve përgjegjëse lokale për secilin element përbërës të riintegritit në vijë me buxhetin që i është caktuar komunës.²⁹

²⁵ Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Viti/Vitina, Lipjan/Lipljan, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Shtime/Štimlje, Istog/Istok, Klinë/Klina, Prizren, Dragash/Dragaš, Malishevë/Mališevo, Suharekë/Suva Reka, Rahovec/Orahovac dhe Gjakovë/Đakovica.

²⁶ Ferizaj/Uroševac, Viti/Vitina, Istog/Istok, Lipjan/Lipljan, Prizren, Dragash/Dragaš, Malishevë/Mališevo, Rahovec/Orahovac dhe Gjakovë/Đakovica.

²⁷ Štrpce/Shtërpce dhe Novobërdë/Novo Brdo.

²⁸ Hani i Elezit/Đeneral Janković, Kačanik/Kaçanik, Prishtinë/Priština, Obiliq/Obilić, Podujevë/Podujevo, Glogoc/Glogovac, Mamuşa/Mamushë/Mamuša, Leposavić/Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan/Zvečan, Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Deçan/Deçane, Pejë/Peć dhe Junik.

²⁹ Strategjia, Kapitulli 9, Mekanizmat bashkërendues për zbatimin e Strategjisë për riintegritin e personave të riatdhesuar.

Siç ishte rasti edhe me zyrtarët komunal për kthim dhe zyrtarët komunal për komunitete, përveç shumë pak përjashtimeve³⁰, zyrtarët e lartë komunal të cilët u intervistuan theksuan që nuk kishin pranuar kopjen e Strategjisë apo të Planit të veprimit dhe nuk ishin të njohur me përmbajtjen e këtyre dy dokumenteve.³¹ Gjithashtu, duket që asnjë nga komunat nuk ka pranuar ndonjë udhëzim shtesë nga pushteti qendror për ta zbatuar kornizën ekzistuese të politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar. Në mënyrë të ngjashme, pushteti qendror nuk e ka zhvilluar apo financuar kurrfarë programi të veçantë qeveritar për ta lehtësuar riintegrimin e personave të riatdhesuar në nivel lokal.

Për më tepër, asnjë komunë nuk i ka themeluar politikat në fushën e riintegrimin të personave të riatdhesuar apo procedurat për t'u marrë me riintegrimin e personave të riatdhesuar. Asnjë buxhet komunal për vitin 2008 apo 2009 nuk parasheh kategori të veçanta apo të planifikuara për riintegrimin e personave të riatdhesuar. Asnjë nga drejtoritë komunale, siç është ajo për shëndetësi apo për arsim, apo zyrtar kompetente për zbatimin e Strategjisë nuk i janë ofruar burimet e veçanta apo shtesë për ta kryer punën e tyre në këtë fushë.

3.2 Riintegrimi në komunat e origjinës

3.2.1 Dokumentet civile

Ka pasur disa përpjekje nga ana e autoriteteve përkatëse lokale për t'i zbatuar objektivat e Strategjisë në lidhje me lehtësimin dhe promovimin e qasjes në dokumente personale për personat e riatdhesuar, në veçanti për personat që i takojnë komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.³²

Një numër i kufizuar i institucioneve vendore gjegjëse raporton të ketë marrë masa të veçanta për të mundësuar regjistrimin civil dhe lëshimin e dokumenteve personale për personat e riatdhesuar, kryesisht duke u ofruar atyre informata për vendet dhe procedurat përmes të cilave mund të regjistrojnë gjendjen e tyre civile apo vendbanimin.³³ Veç kësaj, në disa komuna, zyrtar dhe/ose zyrtarët komunalë të komuniteteve nga qendrat komunale të regjistrimit civil dhe zyrave komunale të gjendjes civile kanë thënë që komuna bashkëpunon ngushtë me UNHCR-në/Programin e për të Drejtat Civile në Kosovë (CRP/K) në lehtësimin e regjistrimit civil të personave që i përkasin komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.³⁴ Kjo përfshin

³⁰ Drejtorët e administratës në Vushtrri/Vučitrn dhe Prizren.

³¹ Në mesin e institucioneve/zyrtarëve lokal të intervistuar ishin kryetarët e komunës, nënkryetarët e komunës, nënkryetarët për komunitete, drejtorët komunalë të administratës dhe personelit, urbanizmit/kadastrit, ekonomisë dhe financave, arsimit, shëndetësisë, si dhe drejtorët e qendrave për punë sociale, zyrtarët komunalë për projekte, zyrtarët ligjorë komunalë, qendrat komunale për regjistrim civil, zyrtarët komunalë për status civil dhe kryetarët e kuvendeve të komunës.

³² Strategjia, Kapitulli 3.1 – Qasja në dokumentet civile.

³³ Pesë zyrtarë komunalë të kthimit (Gjilan/Gnjilane, Podujevë/Podujevo, Prizren, Shtime/Štimlje, Rahovec/Orahovac), gjashtë zyra komunale të komuniteteve (Dragash/Dragaš, Ferizaj/Uroševac, Gjakovë/Đakovica, Gjilan/Gnjilane, Prizren, Mitrovicë/Mitrovica), një zyrë komunale e gjendjes civile (Obiliq) dhe tri qendra komunale të regjistrimit civil (Mitrovicë/Mitrovica, Podujevë/Podujevo, Shtime/Štimlje).

³⁴ Si pjesë e mandatit të saj në lidhje me personat pa shtetësi, UNHCR-ja ka hartuar një plan veprimi për “Fushatën e Regjistrimit Civil, më përqendrim te komuniteti rom, ashkali dhe ai egjiptian në Kosovë” (Zyra e UNHCR-së në Kosovë, Njësia Mbrojtëse e Zyrës së Kryesuesit të Misionit, korrik 2006). Partneri implementues i UNHCR-së, OJQ-ja Programi për të Drejtat Civile në Kosovë

ndihmën për aplikantët në kryerjen e procedurave të regjistrimit civil, kërkimin e dokumenteve dhe gjetjen e dëshmitarëve për të dhënë faktet në lidhje me identitetin e aplikantëve pa të dhëna, si dhe në disa raste, duke i liruar pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian nga tarifatat administrative.

Përveç kësaj, shumë pak, për të mos thënë fare, aktivitete janë ndërmarrë nga autoritetet gjegjëse vendore për të ngritur vetëdijen në mesin e personave të riadhesuar mbi rëndësinë e regjistrimit civil, apo për të shpërndarë informata në mënyrë pro-aktive dhe për të promovuar qasjen në shërbime komunale. Në një numër komunash, drejtorët e administratës dhe zyrtarët nga qendrat komunale të regjistrimit civil dhe gjendjes civile kanë thënë që u takon banorëve që të vijnë tek zyrat gjegjëse për t'i marrë dokumentet civile apo për t'u regjistruar, si dhe që nuk ka nevojë për masa të veçanta. Në këtë kuptim, mungesa e udhëzimeve të pushtetit qendror shpesh rezultojnë me atë që autoritetet të mos kenë qasje fleksibile apo të mos lehtësojnë masa për të siguruar që të gjithë dokumentet civile të nevojshme t'u jepen këtyre personave që të jenë në gjendje t'i gëzojnë dhe ushtrojnë të drejtat e tyre ligjore.³⁵

Mungesa e dokumenteve civile dhe pamundësia e regjistrimit të gjendjes civile mund të ketë pasoja serioze për personat e riadhesuar. Pa regjistrimin e mirëfilltë civil, individët përballen me pasoja të konsiderueshme në riintegrim dhe kanë pak apo fare qasje në shërbime komunale, si dhe në kujdes adekuat shëndetësor, shërbime sociale, punësim dhe mundësi tjera riintegrimi. Ata gjithashtu mund të kenë vështirësi në qasje apo rimarrjen e pronës së tyre.

3.2.2 Shëndetësia

Zbatimi i synimeve të Strategjisë për mundësimin e qasjes së personave të riadhesuar në sistemin shëndetësor të Kosovës, duke përfshirë këtu qasjen ndaj personave të prekur në mënyrë pro-aktive apo/dhe ndërmarrjen e masave të duhura për t'i plotësuar nevojat e tyre specifike shëndetësore³⁶, është i varfër në nivelin lokal.

Në përgjithësi, drejtoritë komunale të shëndetësisë nuk ndërmarrin ndonjë aktivitet (p.sh. aktivitete informimi, dërgim të ekipeve lëvizëse, publikim të broshurave/informatave, fushata vetëdijesimi) për të identifikuar dhe/ose ngritur vetëdijen e personave të riadhesuar mbi çështjet dhe shërbimet shëndetësore në dispozicion. Institucionet komunale kryesisht pretendojnë që personat e riadhesuar nuk kanë ndonjë vështirësi në qasje ndaj shërbimeve shëndetësore kur arrijnë në komunat e tyre të origjinës. Masat e marra në fushën e shëndetësisë përgjithësisht nuk merren në mënyrë të veçantë me personat e riadhesuar. Këta persona nuk lirohen nga

(CRP/K), filloi të implementonte Fushatën e Regjistrimit Civil në shtator të vitit 2006. Gjatë vitit 2007 dhe 2008, CRP/K nënshkroi memorandum mirëkuptimi me 22 komuna duke synuar sigurimin e fleksibilitetit lidhur me procedurat e regjistrimit civil dhe lirimit të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptianë nga pagesat administrative.

³⁵ Strategjia parashikon lëshimin e udhëzimeve administrative nga Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për autoritetet gjegjëse lokale për të mundësuar qasjen në dokumente civile dhe regjistrim civil për personat e riadhesuar (Kapitulli 3.1 Riintegrimi ligjor i personave të riadhesuar – Qasja në dokumente civile).

³⁶ Strategjia, Kapitulli 3.2, Qasja ndaj kujdesit shëndetësor.

tarifat/pagesat për shërbime mjekësore gjatë periudhës së riintegrit të tyre, por trajtohen si secili banor tjetër.³⁷

Problemet me të cilat përballen personat e riatdhesuar kryesisht kanë të bëjnë me mungesën e dokumenteve personale për regjistrim në institucionet shëndetësore³⁸, të dhënat jo të plota mjekësore, si dhe ofrimin e trajtimeve të vazhdueshme të gjendjeve mjekësore në Kosovë. Për më tepër, mungesa e qasjes fizike në institucionet shëndetësore për persona të riatdhesuar në zona rurale mbetet problem për shumicën e familjeve të cenueshme për shkak të mungesës së transportit të duhur publik, si dhe për faktin që ata shpesh nuk kanë mundësi ta paguajnë trajtimin mjekësor dhe barnat.

3.2.3 Arsimi

Strategjia parashikon masa të ndryshme për të mundësuar riintegrimin e fëmijëve të riatdhesuar në sistemin arsimor në Kosovë. Megjithatë, deri më sot, nuk janë bërë hapa konkretë për të marrë masa riintegrimi në këtë kuptim.³⁹

Asnjë plan pune të komunës për arsimin (aty ku janë hartuar të tillë) nuk parashihet kategoria e fëmijëve/të rinjve të riatdhesuar dhe nevojat e tyre të veçanta. Mjetet financiare nuk janë siguruar nga autoritetet gjegjëse për implementimin e programeve të veçanta të riintegrit, duke përfshirë, për shembull, kurse të gjuhës amtare, orë plotësuese apo aktivitete tjera të lira. Në fakt, shumica e drejtorive komunale të arsimit nuk kanë njohuri për ekzistimin e strategjive qeveritare për riintegrimin e personave të riatdhesuar, dhe askush nuk ka marrë udhëzime nga pushteti qendror mbi kushtet, kriteret dhe procedurat për implementimin e tyre,⁴⁰ apo themelimin e programeve të veçanta për plotësimin e nevojave të fëmijëve dhe të rinjve të riatdhesuar.

Në përgjithësi, ndihma për riintegrimin e fëmijëve të riatdhesuar është e kufizuar në ofrimin e informatave bazë për mundësitë dhe shërbimet arsimore në dispozicion. Vetëm në disa komuna departamentet e arsimit kanë ndërmarrë aktivitete për të mbështetur studentët e varfër me tekste apo materiale mësimore pa pagesë.⁴¹ Në përgjithësi, drejtorët komunalë të arsimit kanë deklaruar që ka një mungesë të përgjithshme të fondeve në dispozicion për bursa apo veprimtari të veçanta arsimore që përqendrohen tek fëmijët e kthyer. Vetëm disa institucione apo zyra kanë pasur aktivitete për ngritjen e vetëdijes së personave të riatdhesuar për mundësitë e arsimit, shërbimet në dispozicion, dispozitat ligjore dhe institucionet kryesore, kryesisht përmes aktiviteteve informuese në zonat rurale apo në zonat e banuara nga komunitetet joshumicë.⁴² Megjithatë, iniciativat apo masat e marra në shumicën e

³⁷ Strategjia kërkon që “personat e riatdhesuar do të lirohen nga pagesat e shërbimeve mjekësore deri në riintegrimin e tyre të plotë” (Kapitulli 3.2 Qasja ndaj kujdesit shëndetësor).

³⁸ Sipas informatave në dispozicion, nuk ka nevojë për dokumente identifikimi për kontrolle të përgjithshme mjekësore, ndërsa janë të nevojshme për trajtime speciale dhe hospitalizim.

³⁹ Strategjia, Kapitulli 3.6, Arsimi.

⁴⁰ Strategjia parasheh lëshimin e udhëzimeve të mëtejshme administrative nga Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë, për përcaktimin e kushteve, kriterëve dhe procedurave për implementimin e saj (Strategjia, Kapitulli 3.6 Arsimi).

⁴¹ Për shembull në Istog/Istok, Prizren dhe Rahovec/Orahovac.

⁴² Për shembull, drejtori komunal në Mitrovicë/Mitrovica ka thënë që komuna ndërmerr aktivitete informuese të rregullta në Mëhallën e Romëve në pjesën jugore të Komunës.

rasteve duken të jenë josistematike, dhe se nuk përqendrohen veçanërisht tek fëmijët apo të rinjtë e riatdhesuar.

Kthimi i detyrueshëm ka ndikim veçanërisht negativ te fëmijët që kanë vijuar shkollën jashtë Kosovës për shumë vjet, kanë qenë të integruar në sisteme tjera të arsimit dhe shpesh kanë edhe pengesa gjuhësore gjatë kthimit të tyre në Kosovë. Shumë nga këta fëmijë nuk kanë njohuri të mjaftueshme të gjuhës shqipe apo serbe, si dhe rrjedhimisht përballen me vështirësi në vijimin e mësimit në gjuhët amtare, por edhe për t'iu përshtatur një plan-programi dhe sistemi tjetër shkollor. Për më tepër, probleme ka edhe në kontekstin e sigurimit të dokumenteve të nevojshme për regjistrim (p.sh. certifikatat e lindjes, nostrifikimin apo njohjen e diplomave apo certifikatave të lëshuara në vendet tjera).

3.2.4 Punësimi dhe mirëqenia sociale

Nuk ka pasur përpjekje konkrete nga autoritetet lokale dhe komunale për t'i zbatuar masat në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale, ashtu siç parashihet me Strategji.⁴³

Në përgjithësi, programet e punësimit të paramenduara për personat e riatdhesuar nuk ekzistojnë fare në asnjë nga rajonet e Kosovës. Zyrtarët e qendrave rajonale të punësimit dhe qendrave të trajnimit profesional të konsultuar në gjitha rajonet nuk janë të vetëdijshëm për ndonjë program të veçantë qeveritar të krijuar për t'i ndihmuar këtij grupi personash në punësim apo masa trajnimi. Nuk janë zhvilluar programe/projekte për rritjen e mundësisë së punësimit të personave të riatdhesuar, e as nuk janë promovuar veprimtari të gjenerimit të të ardhurave nga autoritetet lokale. Shumë shpesh, personat e riatdhesuar referohen tek organizatat ndërkombëtare⁴⁴ për informata të mëtutjeshme dhe këshilla për mundësitë e punësimit dhe trajnimit profesional.⁴⁵

Perspektiva e zymtë e punësimit dhe kushtet e vështira socio-ekonomike në Kosovë janë ndër problemet më të shpeshta me të cilat përballen personat e riatdhesuar dhe popullata në përgjithësi. Shumë persona të riatdhesuar janë pa punë apo varen nga punësimi afatshkurtër apo stinor për jetesë. Të ardhurat shpesh plotësohen me asistencë sociale apo forma tjera të ndihmës nga organizatat ndërkombëtare apo joqeveritare, si dhe dërgesat nga anëtarët e familjes që jetojnë jashtë. Në mesin e të papunëve afatgjatë, grupet në pozitë më të pafavorshme janë gratë, romët, ashkalitë, egjiptianët dhe personat me aftësi të kufizuar.

Në shumicën e komunave në të cilat janë regjistruar persona të riatdhesuar gjatë dy viteve të fundit, zyrtarët përgjegjës thonë që rregullisht i informojnë personat e riatdhesuar për skemat sociale në dispozicion, duke përfshirë të drejtat dhe procedurat për regjistrim në skemat e ndihmës sociale dhe pensionale, nëse i qasen në mënyrë të drejtpërdrejtë. Megjithatë, vetëm në një numër të kufizuar komunash autoritetet

⁴³ Strategjia, Kapitulli 3.3, Punësimi; si dhe Kapitulli 3.6, Mirëqenia sociale.

⁴⁴ Tek Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), CARE International, apo OJQ-ja gjermane Arbeitsgruppe Entwicklung und Fachkraefte.

⁴⁵ Këto organizata janë cituar si organizatat e vetme që ofrojnë asistencë për personat e riatdhesuar në formë grantesh për biznese të vogla apo pajisje për bujqësi, programe trajnimi dhe ri-trajnimi, si dhe informata të përgjithshme, këshillime dhe këshilla karriere.

gjegjëse kanë marrë masa pro-aktive për t'i identifikuar individët/familjet që mund të kenë nevojë për ndihmë. Kjo është bërë kryesisht duke i vizituar këta individë dhe familje dhe duke mundësuar kontaktet me zyrat gjegjëse.⁴⁶ Përveç një numri të kufizuar qendrash për mirëqenie sociale dhe zyrtarë komunalë të kthimit që kanë bërë vizita informuese tek personat e riatdhesuar,⁴⁷ asnjë institucion nuk ka aktivitete për ngritjen e vetëdijes së personave të riatdhesuar mbi skemat ekzistuese sociale dhe procedurat e regjistrimit në ato skema.

3.2.5 Banimi dhe vendosja

Strategjia rekomandon miratimin e masave të ndryshme për t'i adresuar nevojat e banimit të personave të riatdhesuar, duke përfshirë ndërtimin e shtëpive dhe programeve banesore për persona të riatdhesuar që nuk janë pronarë tokash dhe/ose pronash.⁴⁸ Megjithatë, deri më sot, nuk është arritur ndonjë përparim konkret në nivelin lokal.

Asnjë nga komunat në Kosovë nuk ka bërë hapa drejt gjetjes së zgjidhjeve të përkohshme dhe/ose të qëndrueshme të banimit për personat e riatdhesuar, dhe asnjëra nga ato nuk ka përfshirë projekte të buxhetuara në planet e tyre buxhetore për t'i plotësuar nevojat banesore të personave të riatdhesuar. Në fakt, asnjë prej komunave nuk ka bërë ndonjë vlerësim të nevojave banesore të personave të riatdhesuar apo nuk ka hartuar propozime për financim nga Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor apo donatorë të jashtëm.⁴⁹

Mungesa e qasjes ndaj banimit dhe vendosjes për personat e riatdhesuar mbetet pengesë madhore për kthim të qëndrueshëm dhe riintegrim. Në shumë raste, pronat janë shkatërruar gjatë konfliktit ose janë gjetur të pabanueshme pas periudhave të gjata të mungesës.⁵⁰ Veç kësaj, një nga problemet më të rëndësishme me të cilat përballen personat që i takojnë komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian është statusi i tyre i paqartë apo i parregulluar ligjor lidhur me banimin, duke i përfshirë çështjet lidhur me pronësinë e tokës. Ata që kanë jetuar në pronë që e kanë poseduar në mënyrë joformale para largimit nga Kosova përballen me sfida të veçanta në qasje ndaj banimit apo llojeve tjera të vendosjes pas kthimit. Në shumë raste, personat e riatdhesuar gjejnë zgjidhje të përkohshme përmes të afërmeve. Megjithatë, shumë raste

⁴⁶ Gjilan/Gnjilane, Ferizaj/Uroševac, Kamenicë/Kamenica, Novobërdë/Novo Brdo dhe Viti/Vitina, Gjakovë/Đakovica, Deçan/Dečane dhe Istog/Istok.

⁴⁷ Për shembull, qendra për mirëqenie sociale në Ferizaj/Uroševac dhe zyrtari komunal i kthimit në Kamenicë/Kamenica raportojnë se kryejnë vizita informimi tek personat e riatdhesuar dhe i informojnë për procedurat e kërkuara.

⁴⁸ Strategjia, kapitulli 5, Banimi social dhe çështjet pronësore.

⁴⁹ Plani i veprimit parasheh plane të hollësishme dhe përfshin projeksione buxhetore nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për rindërtimin e objekteve të banimit social në komuna të ndryshme për të vendosur 175 familje të cënueshme të cilat nuk janë pronare të tokës apo pronave (Synimet 57 dhe 58).

⁵⁰ Për shembull, në Istog dhe Klinë/Klina (rajoni i Pejës/Peć), edhe pse komunat nuk mbajnë regjistra të azhurnuar të personave të riatdhesuar dhe nevojave të tyre të veçanta, vlerësohet që rreth 70-80 për qind të familjeve të riatdhesuara, kryesisht nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, nuk kanë qenë në gjendje të kthehen në shtëpitë e tyre të dëmtuara apo të shkatërruara (burimi: zyrat dhe zyrtarët komunalë të kthimit).

mbesin pa zgjidhje afatgjate të banimit. Disa persona të riatdhesuar kanë gjetur vetëm strehim të përkohshëm në qendrat kolektive apo kampe të personave të zhvendosur.⁵¹

4. PËRFUNDIMET

Strategjia për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe Plani përkatës i Veprimit janë dokumentet kryesore që synojnë sigurimin e zgjidhjeve të qëndrueshme dhe afatgjate për personat e riatdhesuar në fushat e riintegritit ligjor, shëndetit, arsimit, punësimin, mirëqenies sociale, banimit dhe çështjeve pronësore. Megjithatë, Strategjia nuk është zbatuar në mënyrë adekuate as në nivelin qendror, e as në atë lokal.

Në nivelin qendror, janë pak përpjekje për të siguruar që Strategjia dhe Plani i Veprimit t'i shpërndahen në mënyrë adekuate gjithë administratës publike, duke i përfshirë këtu edhe komunat, si dhe për të siguruar që autoritetet përgjegjëse t'i zbatojnë në mënyrë efektive dispozitat e Strategjisë. Si rrjedhim, autoritetet lokale ende nuk janë të informuara sa duhet për përgjegjësitë e tyre karshi personave të riatdhesuar, si dhe nuk kanë marrë udhëzime të mëtutjeshme nga pushteti qendror që i përvijojnë procedurat dhe i ndajnë përgjegjësitë e qarta për autoritetet gjegjëse lokale në fushat përkatëse të riintegritit.

Mekanizmat gjegjës të bashkërendimit dhe referimit mes institucioneve të nivelit qendror dhe atij lokal ende mbetet të themelohen. Deri më sot, komunat as nuk kanë marrë njoftime paraprake për kthimet e detyrueshme që duhen bërë, e as nuk kanë informatat e duhura mbi themelimin e mekanizmave për këmbimin e informatave mes ministrive gjegjëse dhe komunave për bashkërendimin e implementimit të Strategjisë. Si pasojë, asnjë nga komunat nuk ka themeluar politika në fushën e riintegritit të personave të riatdhesuar apo procedurave për mbështetjen e personave të riatdhesuar në arritjen e tyre në komunat e tyre të origjinës.

Përkundër nevojave të veçanta të identifikuar dhe projeksioneve buxhetore të kryera nga ministrinë gjegjëse, Strategjia nuk ka marrë financim direkt në nivelin lokal. Asnjë nga komunat nuk përfshirë shpenzimet në lidhje me implementimin e Strategjisë në buxhetet e tyre, e as nuk janë siguruar mjete financiare për themelimin dhe zbatimin e programeve specifike të riintegritit në fushat e identifikuar nga Strategjia.

Kthimi i qëndrueshëm dhe riintegrimi i personave të riatdhesuar mbetet sfidë madhore për komunat e Kosovës. Përderisa pjesa më e madhe e ndihmës ndërkombëtare në fushën e kthimit përqendrohet në mbështetjen e kthimit vullnetar, personat e riatdhesuar, me kthimin e tyre në Kosovë, shpesh mbeten pa asnjë ndihmë qoftë nga institucionet kosovare apo nga organizatat joqeveritare ndërkombëtare. Qasja e kufizuar në çështjet që lidhen me banim dhe pronë, si dhe vështirësitë për qasje në shërbime themelore, duke përfshirë arsimin, kujdesin shëndetësor, punësimin dhe/ose mundësitë ekonomike, janë disa nga vështirësitë kryesore me të cilat ballafaqohen

⁵¹ Ka pasur raste të raportuara të romëve të kthyer në mënyrë të detyrueshme të cilët kanë gjetur strehim të përkohshëm në kampin e kontaminuar me plumb të Osterodes në Mitrovicën/Mitrovica e veriut, si dhe Mëhallën e Romëve në pjesën jugore të komunës. Janë raportuar edhe raste të skajshme në komunën e Istogut, ku personat e riatdhesuar janë gjetur pa shtëpi, dhe vetëm përmes intervenimit të KFOR-it dhe zyrtarit komunal të komuniteteve ata janë vendosur përkohësisht në një kamp joformal në Gjurakoc/Durakovac.

personat e riadhesuar. Do të ketë nevojë për përpjekje të konsiderueshme nga institucionet gjegjëse në nivelin qendror dhe atë lokal për t'u përballur me këto pengesa dhe për të siguruar kthim të qëndrueshëm dhe riintegrim të personave të riadhesuar.

5. REKOMANDIMET

Rekomandimet për pushtetin qendror:

- Të ndajë financim të nevojshëm qeveritar për të siguruar zbatimin e Strategjisë dhe Planit shoqërues të Veprimit;
- Të themelojë një këshill ndërministror për të mbikëqyrë dhe monitoruar zbatimin e Strategjisë; për t'i bashkërenduar veprimet e ministrive gjegjëse si dhe mes autoriteteve qendrore dhe atyre lokale; si dhe për t'i hartuar udhëzimet e veçanta për autoritetet lokale që i përcaktojnë përgjegjësitë dhe procedurat e qarta;
- Të sigurojë që ministrinë gjegjëse për shëndetësi, arsim, punësim, kujdes social dhe banim, si dhe organet lokale, të jenë të informuara për procesin e ripranimit/riadhesimit;
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për t'i zbatuar synimet e Strategjisë në fushat e riintegritit ligjor, shëndetësisë, arsimin, punësimin, mirëqenies sociale dhe banimit për të siguruar kushte themelore për kthim dhe riintegrim të qëndrueshëm;
- Të sigurojë shpërndarjen e menjëhershme të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të gjitha palët e përfshira, veçanërisht të autoritetet komunale, si dhe të mbahen trajnime për përmbajtjen e Strategjisë për zyrtarët komunalë;
- Ta forcojë statusin ligjor të zyrave komunale për komunitete dhe zyrtarëve komunalë për kthim në kuadër të strukturës komunale, dhe t'u sigurojë këtyre zyrave/zyrtarëve burime të duhura dhe përkrahje për t'ua bërë të mundur ushtrimin e funksioneve të tyre;
- Të bashkëpunojë ngushtë me vendet nikoqire si dhe me organizatat vendore dhe ndërkombëtare joqeveritare për të bashkërenduar ndihmën financiare dhe teknike dhe të lehtësojë zhvillimin programeve të strukturuar dhe të financuara të riintegritit, si dhe ngritjen e kapaciteteve të autoriteteve lokale.

Rekomandimet për autoritetet komunale:

- Të sigurojnë që propozimet buxhetore që i dërgohen pushtetit qendror t'i përfshijnë fondet e domosdoshme për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit në nivel lokal, si dhe të ndajnë mjete të nevojshme nga buxheti komunal sipas nevojave;

- T'i shpërndajnë në mënyrë efikase dokumentet dhe udhëzimet në lidhje me riintegrimin e personave të riatdhesuar te të gjithë zyrtarët gjegjës komunalë, si dhe t'i informojnë ata për rolet përkatëse dhe përgjegjësitë e tyre në zbatimin e atyre synimeve;
- Të ofrojnë mbështetje adekuate financiare, administrative dhe politike për zyrtarët komunalë të komuniteteve dhe zyrtarët komunalë të kthimit për t'ua mundësuar kryerjen e detyrave të tyre;
- Të themelojnë mekanizma bashkërendimi, në të cilat institucionet dhe zyrtarët gjegjës mund të këmbëjnë informata, si dhe të zhvillojnë programe specifike, iniciativa e politika komunale.
- Të ndërmarrin aktivitete informuese dhe seanca të këmbimit të informatave për personat e riatdhesuar mbi qasjen në shërbime komunale, si dhe në arsim, shëndetësi, shërbime sociale, punësim dhe mundësi tjera të riintegrit.

Rekomandimet për organizatat ndërkombëtare dhe vendet nikoqire:

- UNHCR: Të sigurojë udhëzime për autoritetet gjegjëse në vendet nikoqire dhe institucionet e Kosovës mbi nevojat për ndihmë ndërkombëtare të individëve nga Kosova, dhe të monitorojë nga afër nëse procesi i riatdhesimit kryhet në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.
- Vendet nikoqire: T'i marrin në konsideratë të duhur kushtet për pranim dhe riintegrim të personave të riatdhesuar dhe t'i përkrahin institucionet e Kosovës në përmbushjen e obligimeve të tyre.